



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

RAPORTI I VLERËSIMIT TË STAFIT

AKADEMIK, ADMINISTRATËS DHE

ZYRËS FINANCIARE NGA ANA E

STUDENTËVE

Prishtinë, Janar 2026



Datë:	28/01/2026
Për:	Sabri Klaiqi Rektor i KOLEGJIT "PJETËR BUDI"
CC:	Besim AJETI Themelues i KOLEGJIT "PJETËR BUDI" Prorektorja Prorektorë për mësim, hulumtim dhe zhvillim akademik; Prorektorë për buxhet, infrastrukturë, bashkepunim me jashte dhe çeshtje të studenteve;
Nga:	Ilirjana Aliu Koordinatorja për Cilësi e Kolegjit "Pjetër Budi"
Lënda	Raport i procesit të Evaluimit të Stafit Akademik, Administratës dhe Zyrës Financiare.



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK.....	5
PYETJET E REALIZUARA NË PYETËSOR	6
VLERËSIMI I SHËRBIMEVE TË STAFIT ADMINISTRATIV, ADMINISTRATËS DHE ZYRES FIMANCIARE.....	8
REKOMANDIMET E PËGJITHSHME PËR PROFESORËT.....	10



HYRJE

Procesi i Vlerësimit të Stafit Akademik ne Kolegjin "Pjetër Budi" ka filluar me datën 19/01/2026 dhe ka përfunduar me datën 30/01/2026. Vlerësimit i nënshtrohen të gjithë profesorët e nivelit Bachelor dhe Master dhe ky vlerësim konkretisht përfshin vlerësimin e profesorëve nga ana e studentëve dhe vlerësimin e studentëve ndaj shërbimeve të administratës.

Vlerësimet analizojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të Kolegjit në të gjitha fushat e veprimit.

Procesi i vlerësimit të Stafit Akademik është bërë bazuar në Statutin e Kolegjit "Pjetër Budi", Neni: 153.1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve, i kërkimeve shkencore bëhet në këtë mënyrë:

Pika 153.1. Vlerësimet e brendshme përmes vlerësimit vetanëk:

- pyetësorët dhe vetëvlerësimi nga ana e personelit akademik,
- pyetësorët anonim të vlerësimit nga studentët,
- analiza e parametrave në bazë të raportit të punës dhe përmbushjes së obligimeve.

Pika 153.2. Vlerësimet e jashtme nga ekspertët e MASHT-it:

- prezenca në orë,
- raportet e ekspertëve.

Gjatë semestrit dimërorë, në vitin akademik 2025/2026 në nivelin Bachelor kanë qenë të angazhuar 15 mësimdhënës. Vlerësimi është realizuar nga studentët në periudhë një javore gjatë fundit të muajit janar 2026.

Pyetësorët kanë qenë të dizajnuar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë në koordinim dhe konsultim me stafin administrativ, të punuar me Google Forms.

Pyetësi për vlerësimin e Stafit Akademik në nivelin Bachelor dhe Master ka pasur 17 pyetje për të vlerësuar performancën e mësimdhënësit/es në teknikat e mësimdhënies si dhe aspekte tjera të cilat ndërlidhen me aspektet e mësimdhënies, që përdor pyetje për vlerësimin



e lëndës - të cilat janë vlerësuar me vlerën nga 1 deri në 5, ku 1- paraqet vlerën minimale dhe 5 paraqet vlerën maksimale të vlerësimit.

Gjithashtu pyetja e 18 janë përfshirë edhe pyetja kualitative e quajtur si "*Komente, sugjerime, rekomandime apo vërejtje për mësimdhënësin/en e caktuar, administratën apo zyrën finaciare*", ku studentët kanë pasur mundësi të japin komentet e tyre lidhur me mësimdhënësit dhe lëndët të cilat kanë vijuar në atë semestër.

Para plotësimit të pyetësorit, studentëve u është sqaruar procedura e mbushjes dhe më e rëndësishmja u është sqaruar që këto pyetësorë janë anonim dhe konfidencial dhe nuk do të ketë asnjë lloj ndikimi në vlerësimin e tyre për lëndët përkatëse. Poashtu studentëve i'u është bërë e ditur për qëllimin e pyetësorit dhe ndikimin e tij në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie. Pyetësori është shpërndarë në mënyrë elektronike përmes e-mailit tek secili student. Vlerësimet nga studentët realizohen për çdo semestër të vitit akademik. Kjo ka krijuar edhe një kulturë besimi mes studentëve dhe zyrës së cilësisë dhe vazhdon të ketë përmirësime.

VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve bëhet së paku një herë në vit përmes pyetësorëve online edhe fizikisht, 100% anonim që koordinohen nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë. Gjatë këtij semestri, në nivelin bachelor janë vlerësuar nga 15 profesorë të stafit akademik, dmth nga 5 në vitin e parë, 5 në vitin e dytë dhe 5 në vitin e tretë.

Tabela 1: Profesorët në nivelin Bachelor, viti parë – Sem - I-

Ligjëruesi	Lënda e semestrit
Prof. Luljeta Aliu Mulaj	Bazat e Ekonomisë
Prof. Fiknete Bejta	Hyrje në Shkrim Akademik
Prof. Fadil Lekaj/Ass.Gyltene Sylja	Sistemi Doganor
Prof. Fitim Maçani	Bazat e Menaxhmentit
Prof. Atdhetar Gara / Labehet Kryeziu	Teknologji Informative

Tabela 2: Profesorët në nivelin Bachelor, viti dytë – Sem - III-

Ligjëruesi	Lënda e semestrit
Prof. Sabri Klaiqi	Shpedicioni Ndërkombëtar
Prof. Vlora Hajnuni/Limani	Njohja Doganore e Mallrave



Prof. Haqif Arifi	Menaxhimi i Resurseve Njerëzore
Prof. Fadil Lekaj / Ass. Gyltene Syla	Politika dhe Legjislacioni i BE-së
Prof. Atdhetar Gara	Sistemet Informative Doganore

Tabela 3: Profesorët në nivelin Bachelor, viti tretë – Sem - V-

Ligjëruesi	Lënda e semestrit
Prof. Sabri Klaiqi	Shpedicioni Ndërkombëtar
Prof. Vlora Hajnuni/Limani	Njohja Doganore e Mallrave
Prof. Haqif Arifi	Menaxhimi i Resurseve Njerëzore
Prof. Selbije Memeti	Politika dhe Sistemi Fiskal
Prof. Atdhetar Gara	Sistemet Informative Doganore

PYETJET E REALIZUARA NË PYETËSOR

Pyetësorit në nivelin Bachelor i'u kanë përgjigjur 16 studentë, tetë (8) nga viti parë, dhe nga katër (4) viti dytë dhe viti tretë. Më poshtë gjeni të gjeturat gjenerale për profesorët në nivelin BA, të shprehura me përqindje në bazë të vlerësimit nga studentët prej numrit 1 tek 5.

1. Si e vlerësoni sa ju nevojitet lënda e mësimdhënës/it/es të caktuar?

Shkalla e kënaqshmërisë 1, 2, 3. (1 -shumë, 2 -pak, 3-aspak, 4 -nuk e di)

2. Mësimdhënësi/ja është mirë i/e përgatitur në ligjërata dhe shpjegon qartë?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm)

3. Prezantimi i materialit (syllabusi, literatura, sllajdat) nga ana e mësimdhënësit/es janë të qarta dhe të kuptueshme?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

4. Mësimdhënësi/ja është i/e hapur ndaj pyetjeve, mendimit kritik dhe komenteve të juaja?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

5. Mësimdhënësi/ja nxit diskutimet në klasë dhe jep hapësirë për interaktivitet të mjaftueshëm?



Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

6. Si e vlerësoni ju sa janë testet/kollokuimet, ushtrimet në klasë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimet e lëndës?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk e njoh)

7. Mësimdhënësi/ja ligjëron qart dhe është i kuptueshëm?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

8. Mësimdhënësi/ja përfshin zhvillimet më të reja në përmbajtjen e ligjëratave edhe jasht materialit bazë?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

9. Mësimdhënësi/ja iu përgjigjet kërkesave të studentëve dhe përfshin kërkesat e tyre në përmirësimin e lëndës?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

10. Mësimdhënësi/ja është real për të vlerësuar në detaje punën e studentit gjatë gjithë vitit deri te nota përfundimtare?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

11. Mësimdhënësi/ja ka mbajtur ligjëratat rregullisht, në kohën dhe orarin e paracaktuar?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

12. Lënda e këtij mësimdhënësi/se ka rritur ndjeshëm nivelin e njohurive të mia në këtë fushë?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

13. Mësimdhënësi/ja dërgon njësitë mësimore (sllajdet, detyrat, ushtrimet, materialin bazë/shtesë etj) rregullisht dhe në kohën e duhur?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)



14. Mësimdhënësi/ja ka pëgatitur testin/kollokuimet sipas materialit ligjërues/prezantues dhe e ka vlerësuar profesionalisht dhe meritore?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -dobët, 2- mjaftueshëm, 3 -mirë, 4 - shumë mirë, 5- shkëlqyeshëm, 6- nuk i njoh)

15. Mësimdhënësi/ja ligjëron?

Shkalla e kënaqshmërisë nga 1 deri në 5 (1 -mirë dhe në këmbë, 2- mirë por ulur, 3 -jo mirë por në këmbë, 4 -jo mirë dhe ulur, 5- nuk e njoh)

16. Sa jeni të kënaqur me shërbimet e administratës?

17. Sa jeni të kënaqur me shërbimet e zyrës financiare?

18. Komente, sugjerime, rekomandime apo vërejtje për mësimdhënësin/en e caktuar, administratën apo zyren financiare?

VLERËSIMI I SHËRBIMEVE TË STAFIT ADMINISTRATIV, ADMINISTRATËS DHE ZYRES FINANCIARE

Në pyetësin e hartuar për stafin akademik të Kolegjit "Pjetër Budi" një rubrikë është përfshirë për t'i vlerësuar edhe shërbimet e administratës së Kolegjit po ashtu edhe rekomandimet e studentëve. Edhe për vlerësimin e shërbimeve të administratës janë përdorur vlerësimi nga 1 tek 6, ku 1 paraqet vlerën minimale ndërsa 5 vlerën maksimale, kurse 6 ata që nuk kanë marrë pjesë në ligjëratat.


Metodat e vlerësimit:

- 1 - dobët,
- 2 - mjaftueshëm,
- 3 - mirë,
- 4 - shumë mirë,
- 5 - shkëlqyeshëm,
- 6 - nuk i njoh.

Nga 16 studentë të cilët kanë plotësuar këtë pyetësor, përgjigjet janë si vijojnë: Tek pjesa e pyetjes kualitative: "Komente, sugjerime, rekomandime apo vërejtje për mësimdhënësin/en e caktuar, administratën apo zyren financiare", studentët u përgjigjën si vijon:




Foto është shkëputur nga pyetësori për studentët e nivelit bachelor, viti parë, sem I



Komentet e shkëputura nga pyetësori për studentët e nivelit bachelor, viti dytë, sem III

- Jam i kënaqurë
- Shumë të mirë
- Mirë
- Nuk kam diçka

Kometet e shkëputura nga pyetësori për studentët e nivelit bachelor, viti tretë, sem V



Kurse te kjo pyetje për *Komente, sugjerime, rekomandime apo vërejtje për mësimdhënësin/en e caktuar, administratën apo zyren finaciare* te viti dytë, sem III dhe viti III, sem V nuk ka pasur komente fare. Shiko në GoogleForms.

https://docs.google.com/forms/d/125YWowJuNkez_EZbPuVbqIIVBZmqJOvJbjY_KgMu0p-g/edit.



Një pjesë e madhe e komenteve ose mbi 97% e studentëve janë shumë të kënaqurë me stafin akademik dhe ka komete shumë pozitive për mënyrën se siprofeorat ligjërojnë, komunikojnë me studentët dhe bëjnë interaktivitet gjatë ligjëratave, mirëpo gjithmonë duhet të synohet në maksimalizimi i profesorit në mësimdhënie dhe nga ana e studentëve maksimalizimi në mësimnxënie.

Gjithashtu edhe me Administratën dhe zyrën financiare mbi 80% janë të kënaqur me shërbimet që marrin, në kohë dhe korrektësi.

REKOMANDIMET E PËGJITHSHME PËR PROFESORËT

Konform saj Zyra e Cilësisë nxjerr këto pesë (5) rekomandime kryesore nga vlerësimi i profesorëve, administratës dhe zyrës së cilësisë nga studentët, që janë;

1. Të forcohet procesi i vlerësimit periodik të stafit akademik, duke u bazuar në standardet e sigurimit të cilësisë dhe kriteret e përcaktuara institucionale.
2. Të rritet pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, përmes pyetësorëve anonimë dhe analizës së rregullt të rezultateve.
3. Të avansohet dhe shpreshtohet vlerësimi kolegial (kolegu - kolegun) si një mekanizëm shtesë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e praktikave të mira akademike.
4. Të organizohen trajnime dhe programe të zhvillimit profesional për stafin akademik, veçanërisht në metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.
5. Rezultatet e vlerësimit të përdoren për hartimin e planeve konkrete për përmirësim dhe zhvillim akademik, në mënyrë që të rritet vazhdimisht cilësia e mësimdhënies në institucion.

Prishtinë 28.01.2026

Prof.ass.dr Sabri Klaiqi

Rektor i Kolegjit "Pjetër Budi"